

Distrikti i Shkollave Publike Worcester

Shkolla e Mesme Doherty Memorial Akademia e Inxhinierisë dhe Teknologjisë (ETA)

POLITIKA E PRANIMIT KAPITULLI 74

E Ndryshuar në Vjeshtë, 2015

PROPOZIM

Procesi i pranimit është i nevojshëm për Shkollat Publike të Distriktit të Worcesterit në fushën e arsimit teknik profesional ku hapësira është një faktor kufizues. Laboratorët profesionalë teknikë (punishtet) janë të projektuara dhe të pajisura që ti shërbejnë një numri maksimal të nxënësve në mënyrë të sigurt. Si pasojë, një kompleks laboratorësh të tillë nuk ka hapësirën dhe fleksibilitetin për të akomoduar nevojat e mundshme dhe/ose interesin e të gjithë aplikantëve. Për këtë arsye, një proces përzgjedhës nevojitet për të përcaktuar cilët aplikantë mund të përfitojnë më shumë nga mundësi të tilla edukative. Të gjithë aplikantët e Akademisë së Inxhinierisë dhe Teknologjisë në Shkollën e Mesme Doherty Memorial do të vlerësohen sipas kriterëve që përmban kjo Politikë Pranimit.

MUNDESI EDUKIMI TE BARABARTA

Shkollat Publike Worcester pranojnë nxënës dhe vënë në dispozicion të tyre avatazhet, privilegjet dhe kurset e studimit pa bërë diskriminim kundër statusit të tyre si anëtarë të popullsisë të veçanta ose racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit-gjinor, fesë, origjinës kombëtare, aftësisë në gjuhën Angleze, aftësive të kufizuara, ose orientimit seksual.

Nëse ekziston ndonjë nxënës që aftësitë e tij në Anglisht janë të kufizuara, një përfaqësues i kualifikuar nga Shkolla e Mesme Doherty Memorial dhe/ose nga shkolla 8-vjeçare dërguese do ta ndihmojë aplikantin në plotësimin e formularëve të nevojshëm dhe do ti ofrojë ndihmë për përkthim gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe të pranimit sipas kërkesës së aplikantit.

Nxënësit me aftësi të kufizuara mund të vetë-identifikohen vullnetarisht me qëllim që të kërkojnë akomodime të arsyeshme gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe pranimit.

Informacioni mbi aftësitë e kufizuara në gjuhën Angleze dhe paaftësisë të dorëzuara vullnetarisht nga kërkuesi, me qëllim që ai të marrë ndihmë dhe të akomodohet gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe të pranimit, nuk do të influencojë negativisht në pranimitn e tyre në akademi.

E DREJTA E APLIKIMIT

Çdo nxënës i klasës së 8-të i cili pret të pranohet në klasën që ai kërkon të hyjë ka të drejtë të aplikojë për tu pranuar programin e vjeshtës në bazë të disponueshmërisë së hapësirës në Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë. Nxënësit rezidentë do të vlerësohen në bazë të kriterëve që përmban kjo Politikë Pranimit.

Nxënësit rezidentë të transferuar nga shkollat e distrikteve të tjera kanë të drejtë të aplikojnë për tu pranuar në vjeshtë ose për tu pranuar gjatë vitit shkollor të klasës së 9-të ose 10-të në Shkollat Publike Worcester me kusht që ata të presin të pranohen në klasën që ata kërkojnë të hyjnë nga shkolla e tyre aktuale. Nxënësit e transferuar do të vlersohen në bazë të kriterëve që përmban kjo Politikë Pranimi.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Shkollat Publike Worcester kanë një program teknik profesional të miratuar nga Kapitulli 74 i vendosur në Shkollën e Mesme Doherty Memorial. Kjo shkollë është anëtare e Shoqatës së New England të Shkollave dhe Kolegjeve. Shkolla e Mesme Doherty Memorial është e angazhuar të sigurojë një program cilësor akademik, profesional dhe teknik.

Është përgjegjësia e Shkollave Publike Worcester të mbikqyrin administrimin e politikave dhe procedurave të nevojshme për të pranuar dhe regjistruar aplikantët në përputhje me këtë Politikë Pranimi.

Çdo shkollë ka një Komision Pranimi i caktuar nga Drejtori. Komisioni përbëhet nga një anëtar i Administratës, Zyrës së Udhëzimeve të Shkollës, Departamentit të Nevojave të Veçanta (nëse nevojitet), Departamenteve Akademike, Profesionale dhe Teknike. Përgjegjësitë e Komisionit të Pranimi përfshijnë:

- përcaktimin e standarteve për pranim
- zhvillimin dhe zbatimin e procedurave për pranim
- shqyrtimin e aplikimeve
- renditjen e nxënësve
- pranimin e nxënësve sipas procedurës dhe kriterëve në politikën e pranimi
- krijimin dhe mirëmbajtjen e një liste pritjeje të kandidatëve për pranim

Shkollat Publike Worcester nuk bëjnë pjesë në Programin e Përzgjedhjes së Shkollës.

PROCESI I REKRUTIMIT

Distrikti i Shkollave Publike Worcester shpërndan informacion nëpërmjet një shumëllojshmëri metodash. Çdo aplikant i interesuar ka të drejtën të ketë një broshurë mbi Programin e Studimit të Akademisë së Inxhinierisë dhe Teknologjisë, i cili përmban aplikimin dhe informacione të tjera themelore.

Një aplikim dhe një letër shoqëruese dërgohet tek të gjithë nxënësit e klasës së 8-të të SHPW (WPS) në vjeshtë ku informohen mbi Takimin Mikpritës në Doherty, që zakonisht mbahet në fillim të Nëntorit. Përfaqësues nga AIT (ETA) do të jenë të pranishëm tek ky Takim Mikpritës për të dhënë informacion dhe për tu përgjigjur pyetjeve të nxënësve dhe familjeve të tyre.

Personeli dhe nxënësit e Akademisë së Inxhinierisë dhe Teknologjisë vizitojnë Shkollën 8-vjaçare Forest Grove, Burncoat Middle, Sullivan Middle, dhe Worcester East Middle në periudhën e dimrit për të shpërndarë informacion, për tu përgjigjur pyetjeve, dhe për të theksuar pikat kryesore të programit në Shkollën e Mesme Doherty Memorial. Aplikimet i jepen çdo nxënësi.

Të dhëna mbi programin, duke përfshirë aplikimet, i dërgohen stafit të zyrës së udhëzimeve në shkollat private dhe shkollave lokale për të informuar nxënësit me mënyrën si e shohin ata të arësyeshme.

Prindi /kujdestari mund të caktojë vizita individuale në një kohë reciprokisht të përshtatshme. Aplikimet dhe literatura shtesë do të jetë në dispozicion në pavionin e Akademisë së Inxhinierisë dhe Teknologjisë, po ashtu dhe në zyrën e udhëzimeve të Shkollës së Mesme Doherty Memorial.

PROCESI I APLIKIMIT

1. Nxënësit e interesuar për të aplikuar në Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë të miratuar nga Kapitulli 74 në Shkollën e Mesme Doherty Memorial për pranim në klasën e 9-të duhet:
 - a. të marrin një aplikim nga Këshilltari i Zyrës së Udhëzimeve të shkollës dërguese në fillim të vitit shkollor sa më shpejt të jetë e mundur, ose të përdorin aplikimin e dërguar nëpërmjet postës ose të përdorin aplikimin e siguruar gjatë vizitës në shkollë.
 - b. të kthejnë formularin e aplikimit të plotësuar tek Këshilltari i Zyrës së Udhëzimeve të shkollës dërguese në kohën e duhur, në përputhje me detajet për pranim të spjeguar më poshtë.
 2. Është përgjegjësia e Këshilltarit të Zyrës së Udhëzimeve të shkollës dërguese të:
 - a. plotësojë pjesën e tij të formularit të aplikimit.
 - b. dërgojë aplikimin e plotësuar tek Koordinatori i Pranimit të Shkollës Doherty sa më shpejt të jetë e mundur.
- Aplikimet e plotësuara përfshijnë:
- ✓ Formularët e aplikimeve të plotësuara (përfshi nënshkrimet e kërkuara)
3. Nëse aplikimet e plotësuara pranohen, do të ndiqen procedurat e mëposhtme:
 - a. Zyra Pranuese/Zyra e Udhëzimeve e Shkollës së Mesme Doherty do të njoftojnë Këshilltarin e Zyrës së Udhëzimeve të shkollës dërguese përgjegjëse për paraqitjen e kërkesës që kërkesa është e paplotësuar dhe do të kërkojë plotësimin e saj.
 - b. Prindi/kujdestari i aplikantit do të njoftohet në rast se Këshilltari i Zyrës së Udhëzimeve të shkollës dërguese nuk e zgjidh problemin.
 - c. Aplikimet e papërfunduara nuk do të pranohen. Aplikimet e papërfunduara nuk do të merren parasysht.

APLIKIMET E VONUARA

Aplikimet e pranuar pasi ka filluar shqyrtimi paraprak do të vlerësohen duke përdorur të njëjtat kritere si aplikimet e tjera dhe do të integrohen sipas renditjes në listën e përcaktuar të pritjes.

NXENESIT E LARGUAR

Nxënësit që largohen nga një program i veçantë i distriktit dhe që frekuentojnë ose jo një shkollë tjetër të mesme mund të riaplikojnë në Distrikt duke ndjekur procedurat e mëposhtme të përfshira në politikën e pranimit dhe do të vlerësohen duke përdorur kriteret që përmban Politika e Pranimit.

KRITERET E PERZGJEDHJES

Për të aplikuar në Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë, çdo nxënës duhet të jetë në nivelin e klasës përkatëse përsa i përket aftësisë së tij për të lexuar, dhe duhet të jetë aktualisht i regjistruar në/ ose të ketë kaluar Algjebren I.

Misioni i Shkollës së Mesme Doherty Memorial dhe i Akademisë së Inxhinierisë dhe Teknologjisë është që të arsimojë të gjithë nxënësit. Personeli dhe stafi i Akademisë së Inxhinierisë dhe Teknologjisë promovon standarte të larta akademike dhe teknike për të gjithë nxënësit.

Pranimi në Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë përcaktohet duke përdorur aplikimin. Aplikimet e plotësuar do të mblidhen dhe do të renditen në bazë të rezultateve neto të kombinuara (nga 100 pikë) ashtu si spjegohet në aplikim. Ndërprerja për aplikimet e pranuar do të përcaktohet nga dy faktorë. Departamenti i Arsimit të Massachusetts ofron një raport maksimal të rekomanduar mësues-nxënës dhe një minimum prej një foot në katror për kërkesat e nxënësve për programet e miratuara nga Kapitulli 74. Numri maksimal i nxënësve të regjistruar në Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë do të varet nga kombinimi i këtyre dy faktorëve.

Regjistrimi maksimal i nxënësve në programin e klasës së 9-të për vitin 2015-2016 ishte 115 nxënës.

PROCESI I PERZGJEDHJES

Komisioni i Pranimi të Shkollës së Mesme Doherty Memorial do të shqyrtojë të gjitha aplikimet për të verifikuar nëse kërkesat paraprake janë plotësuar. Të gjithë nxënësit që do të pranohen në Akademinë e Inxhinierisë dhe Teknologjisë duhet të jenë në nivelin e klasës përkatëse përsa i përket aftësisë së tyre për të lexuar, dhe duhet të jenë aktualisht të regjistruar në/ose të kenë kaluar Algjebren I. Rezultatet e provimit të MCAS-it të nxënësit të Klasës së 8-të mund të përdoren për të përcaktuar nëse nxënësi është në nivelin e klasës përkatëse në lidhje me Gjuhën Angleze dhe Matematikën.

Aplikimet rishikohen, shqyrtohen dhe renditen në bazë të rezultatit neto të përcaktuar nga kombinimi i Performancës Akademike (40%), Sjelljes/Përpjekjes (20%), dhe Frekuentimit/Vonesave (20%) për klasat e 7-ta and 8-ta, si dhe nga Vlerësimi Personal (20%) i plotësuar nga një anëtar i stafit të shkollës dërguese.

Stafi i Zyrës Pranuese të Udhëzimeve rishikon të gjitha aplikimet dhe protokollet e shkollës. Verifikohet nëse kërkesat paraprake janë respektuar. Numri i aplikantëve të pranuar në programin e Klasës së 9-të do të bazohet në regjistrimin maksimal në dispozicion për atë vit shkollor (115 nxënës për vitin shkollor 2015-2016)

Aplikimet mblidhen dhe shqyrtohen gjatë fillimit të Shkurtit. Nga mesi i Shkurtit, Shkolla e Mesme Doherty Memorial u dërgon letra të gjithë aplikantëve duke i informuar nëse janë pranuar në AIT (ETA) ose janë vendosur në listen e pritjes . Përcaktimi bazohet në renditjen e rezultateve të aplikimeve të kombinuara me numrin maksimal të nxënësve që kualifikohen të hyjnë në program.

Nëse nxënësit e pranuar më vonë largohen nga AIT (ETA), Stafi i Pranimi të Doherty Memorial do ti ofrojë vendet nxënësve që janë në krye të listës së pritjes.

Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve janë pranuar nga çdo shkollë e miratuar do të njoftohen për statusin e tyre nëpërmjet një letre të dërguar prindërve/kujdestarëve.

REGJISTRIMI

Në mënyrë që të regjistrohen në vjeshtë në këto programe të miratuara nga distrikti, aplikantët duhet të kenë kaluar në klasën në të cilën ata dëshirojnë të hyjnë nga shkolla e tyre dërguese . Përveç kësaj, ata duhet të kenë kaluar klasën e Gjuhës Angleze ose ekuivalentin e saj dhe matematikën për vitin shkollor menjëherë para regjistrimit.